

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

Seanca plenare

Nr. 02-44/05-07

Prishtinë, më 22 shkurt 2007, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Bislim Hoti**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 82 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 8 shkurtit 2007, si dhe i tarnskripteve të 8 dhe të 9 shkurtit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për letërnjoftimin,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësinë publike,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet shëndetësore,
7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Hetimor për të Gjeturat Faktike në Kuvendin e Kosovës sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm,
8. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit drejtues të Autoritetit Bankar të Kosovës,
9. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Këshillit të Kosovës për Ujërat.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

**Kuvendi**, me propozim të kryetarit, **mbajti një minutë heshtje** në shenjë nderimi për dy qytetarë që kishin humbur jetën në protestat e 10 shkurtit 2007.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** tha se Kryesisë së Kuvendit i kanë arritur dy propozime për rendin e ditës: a) Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese i ka rekomanduar Kuvendit emërimin tre qyqarëve dhe b) Qeveria e Kosovës ka kërkuar të hiqet nga rendi i ditës pika e tetë.

Deputeti **Gani Koci** kërkoj shpjegime nga kryeministri për tërheqjen e pikës së tetë.

Kryeministri **Agim Çeku**, gjatë arsytimit për heqjen e pikës së tetë, tha se Qeveria i ka propozuar Kuvendit dy kandidatë për anëtarë të Bordit drejtues të Autoritetit Bankar të Kosovës. Në ndërkohë PSSP-ja ka kërkuar nga Qeveria që kandidati i propozuar, z. Ali Sadria, nuk mund të jetë anëtar i atij bordi, ngase për atë pozitë nuk mund të jenë persona politikë, kurse ai është deputet i Kuvendit të Kosovës. Koalicioni qeveritar ende nuk është konsultuar për kandidatin tjetër, andaj kërkojmë që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës.

**Sadudin Berisha**, nënkryetar i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, tha se Kuvendi në seancën e mbajtur më 21 shtator 2006 kishte miratuar listën për emërimin e 17 gjyqtarëve dhe të prokurorëve, kurse për pesë kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë kishte kërkuar informata shpesh nga Këshilli Gjyqësor për të kaluarën e tyre. Këshilli Gjyqësor, pas verifikimit të biografive të tyre, Kuvendit i ka parashtruar kërkesën për emërimin e tre kandidatëve për gjyqtarë.

Deputeti **Bajrush Xhemajli**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoj që propozimi për emërimin e tre gjyqtarëve të shtyhet për seancën e radhës, ngase deputetët nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për ta shqyrtuar këtë propozim.

Deputeti **Alush Gashi** tha se Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet kërkesën e parafolësit të tij, ngase emërimi i tre gjyqtarëve nuk është çështje e ngutshme për t'u radhitur në seancën e sotme.

Deputetja **Selviqe Halimi** në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural kërkoj që propozimi për formimin e Këshillit për Ujërat të shtyhet për seancën e radhës.

**Kryetari** i hodhi në votim propozimet e parashtruara.

**Kuvendi**, me shumicë votash, vendosi që pikat e 8, 9 dhe 10 të shtyhen për seancën e radhës.

## **2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 8 shkurtit 2007, si dhe i tarnskripteve të 8 dhe të 9 shkurtit 2007**

Deputetja **Teutë Sahatçiu** pati vërejtje në faqen e shtatë të procesverbalit, ngase nuk ishte përfshirë emri i saj gjatë diskutimit për shpalljen e 27 prillit – Ditë e të Pagjeturve të Kosovës.

Deputeti **Bislim Hoti** pati vërejtje në faqen e 72 të transkriptit të seancës plenare të 9 shkurtit 2007, ngase nuk ishte përfshirë një pjesë e diskutimit të tij.

Deputeti **Fetah Berisha** pati vërejtje në faqet e 87 dhe 88 të transkriptit të seancës plenare të 9 shkurtit, ngase nuk ishin evidencuar në mënyrë të drejtë disa fjalë gjatë diskutimit të tij.

**Kryetari** tha se ngarkohet administrata e Kuvendit t'i bëjë korrigjimet e duhura në bazë të vërejtjeve të deputetëve.

**Kuvendi**, me vërejtjet e cekura më lart, e miratoi procesverbalin e seancës plenare të 8 shkurtit, si dhe transkriptet e seancave plenare të 8 edhe të 9 shkurtit 2007.

### **3. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, lidhur me zhbllokimin e privatizimit të ndërmarrjeve dhe të objekteve shoqërore në komunën e Shtërpcës dhe në komunat e tjera të banuara nga komuniteti serb.

Kryeministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, lidhur me mospublikimin e raportit të Auditorit të Përgjithshëm për të gjeturat faktiken në AKM.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me shkalën e rritjes ekonomike dhe hapjes së vendeve të reja të punës.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadërgjonaj.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** i parashtrroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me gërryerjet në magjistralin Prishtinë-Pejë.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadërgjonaj.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit lidhur me kushtet e vështira në disa objekte të shkollave në komunën e Vitisë.

Ministri **Agim Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për letërnjoftimet**

**Kryetari** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, **Blerim Kuçi**, në emër të Qeverisë së Kosovës arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim zëvendësministri **Kuçi** shpjegoi materien, objektivat, strukturën e Projektligjit të radhitur në shtatë kapituj dhe në 28 nene, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Kuçi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: **Agim Krasniqi** në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Selviqe Halimi** në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Naim Maloku** në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Nazim Jashari** në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s dhe **Mahir Yagcilar** në emër të Grupit Parlamentar 6 plus. Në diskutim morën pjesë edhe këta deputetë: **Qibrije Hoxha, Ramadan Kelmendi, Xhavit Haliti, Nimon Alimusaj, Xhezair Murati, Fetah Berisha, Behxhet Brajshori dhe Ilaz Pireva**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 64;

Kundër----- 6.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim Projektligjin për letërnjoftimet.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Siguri - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

## 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësinë publike

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Kryetarja e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku** tha se komisioni e tërheq pikën “x” të amendamentit 2, si dhe amendamentin e 19-të.

**Kryetari** i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Projektligjin për shëndetësinë publike.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----66;

Kundër----- 2.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për shëndetësinë publike.

## 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet shëndetësore

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Projektligjin për sigurimet shëndetësore.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----68;  
Kundër----- 1.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për sigurimet shëndetësore.

## 7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm

**Kryetari** e ftoi kryetarin e Komisionit Hetimor ta arsyetonte raportin para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisionit Hetimor, **Ferid Agani** tha se Komisioni, në bazë të mandatit që ka marrë në Kuvend më 3 nëntor 2006, ka hulumtuar të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës në bazë të raportit të Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 1 korrik 2004 - 31 mars 2006, duke përfshirë edhe ngjarjet e rëndësishme para dhe pas kësaj periudhe.

Komisioni ka punuar në bazë të Rregullores së punës, planit veprues, kornizës metodologjike për shqyrtimin e çështjeve të ngritura, si dhe dokumentacionit plotësues, që i është bashkangjitur këtij raporti, si shtojcë e veçantë.

Rrethanë kufizuese për punën e Komisionit ka qenë zhvillimi paralel i procedurave hetimore nga organet përgjegjëse, si dhe mungesa e kornizës ligjore.

Komisioni, në bazë të hulumtimeve, ka konstatuar se në Kuvendin e Kosovës nuk ka pasur transparencë të mjaftueshme. Kishte pasur tendenca për keqpërdorimin e fondeve publike, veçanërisht nëpërmjet praktikave joligjore në procesin e prokurimit, keqpërdorim të hierarkisë zyrtare, si dhe në disa raste manipulime (fshehje) të dokumentacionit zyrtar.

Shkaktarë të drejtpërdrejtë të kësaj gjendjeje ishin: përvetësimi dhe keqpërdorimi i kompetencave dhe i përgjegjësi në nivelin politik dhe administrativ të vendimmarrjes, tendenca për instalimin e praktikave joligjore në menaxhimin e fondeve publike nga ana

zyrtarëve të lartë politikë dhe administrative të Kuvendit, mungesa e rregullativës juridike që ka rezultuar me mungesën e praktikave pozitive në marrëdhëniet ndërmjet nivelit politik dhe administrativ të vendimmarrjes në Kuvend, përgjegjësia individuale dhe kolektive në nivelet më të larta të vendimmarrjes politike dhe administrative në Kuvend, mungesa e kornizës së domosdoshme rregullativë dhe e mekanizmave të kontrollit të brendshëm gjatë menaxhimit të buxhetit në Kuvend, veprimi joligjor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe veprimi joligjor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Komisioni ka konstatuar se ekziston përgjegjësia politike e ish- kryetarit të Kuvendit, e Kryesisë së Kuvendit në mandatin e parë dhe e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, si dhe përgjegjësia administrative e ish- sekretarit të Kuvendit dhe e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Komisioni ka konstatuar se të gjeturat faktike në raportin e auditorit të përgjithshëm ishin të sakta, me përjashtim të referencës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Hidroterm” nga Suhareka.

Me qëllim të eliminimit të rrethanave që kanë mundësuar veprime të paligjshme në Kuvend për periudhën raportuese, si dhe për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme në të ardhmen, Komisioni i rekomandon Kuvendit t’i marrë këto veprime:

- Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të Komisionit për Buxhet dhe Financa gjatë shpenzimit të fondeve publike.
- Mbështetja e Komisionit për Buxhet dhe Financa me ekspertë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për monitorimin e shpenzimeve të fondeve publike.
- Informimi i rregullt i Komisionit për Buxhet dhe Financa me raportet përkatëse të Zyrës së auditorit të përgjithshëm dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave në pajtim me ligjin.
- Hartimi i rregulloreve përkatëse për ekzekutimin e buxhetit të Kuvendit, duke përfshirë politikat dhe procedurat e përmendura në raport në mënyrë më detale.
- Themelimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm përkitazi me shpenzimin e buxhetit të Kuvendit, duke përfshirë themelimin e organit për auditim të brendshëm në pajtim me ligjin.
- Përmirësimi i procedurave të brendshme për përpilimin e buxhetit të Kuvendit.
- Hartimi i Rregullores së punës së Kryesisë të Kuvendit.
- Pplotësimi i Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e administratës së Kuvendit me dispozitat që rregullojnë mënyrën e raportimit të rregullt të sekretarit të Kuvendit në Kryesinë e Kuvendit dhe së paku një herë në vit të Kryesisë së Kuvendit në Kuvend.
- Nxjerrja e Ligjit për Komisionin Hetimor.
- Sshqyrtimi i përgjegjësive në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik përkitazi me anulimin e vendimit të organit Rregullativ të Prokurimit Publik nga pika e 7.4.9 e këtij raporti.
- Shqyrtimi i përgjegjësive në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave përkitazi me lejimin joligjor të pagesës nga pika 7.4.10 e këtij raporti.
- Miratimi i Ligjit për auditimin e përgjithshëm.

Në fund, kryetari i Komisionit Hetimor, **Ferid Agani**, i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë raport.

Pastaj **kryetari** e hapi debatin për raportin e Komisionit Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për raportin e Komisionit Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm dhanë: **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Bajrush Xemajli** në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Gjylnaze Syla** në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Teutë Sahatçiu** në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s dhe **Husnija Beshković** në emër të Grupit Parlamentar 6 plus. Në diskutim morën pjesë edhe këta deputetë: **Sanije Aliaj, Fadil Geci, Ramë Buja, Lulzim Zeneli, Besa Gaxheri, Milazim Haliti, Teutë Hadri-Ramadani, Ramadan Kelmendi, Gazmend Muhaxheri, Naser Osmani, Sabit rrahmani, Mark Krasniqi, Fetah Berisha, Bajram Kosumi, Genc Gorani, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Gani Koci, Behxhet Brajshori, Nazim Jashari, Sabri Hamiti, Agim Krasniqi dhe Xhavit Haliti**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas përfundimit të debatit, kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit të Komisionit Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica;  
Kundër----- 5;  
Abstenime----- 1.

**Kryetari konstatoi:** kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi raportin dhe rekomandimet e Komisionit Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvendin e Kosovës sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm.

Kryetari seancën e deklaroi të mbyllur në orën 16:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

E hartoi

**Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**